

FJALA E GVERNATORIT

Zhvillimet ekonomike dhe monetare në vend vijojnë të mbeten në një trajektore pozitive.

Ekonomia shqiptare shënoi një rritje prej 3.6% në gjysmën e parë të vitit dhe të dhënat indirekte sugjerojnë një ecuri të ngjashme edhe në gjashtëmujorin e dytë. Rritja ekonomike është përkthyer në rritje të punësimit dhe të pagave në sektorin privat jobuqësor, duke sjellë më shumë të ardhura për familjet shqiptare. Po ashtu, rritja e kërkesës për mallra e shërbime është përkthyer në rritje të shitjeve dhe një situatë të mirë financiare të biznesit shqiptar.

Ndonëse në rritje të lehtë gjatë tremujorit të tretë, inflacioni i çmimeve të konsumit ka qëndruar në nivele të ulëta dhe poshtë objektivit tonë gjatë vitit 2025. Kjo dinamikë ka pasqyruar një ecuri relativisht të balancuar të kërkesës dhe ofertës në ekonomi, forcimin e kursit të këmbimit, i cili ka absorbuar presionet inflacioniste nga tregu i huaj, si dhe goditjet e ofertës, të cilat kanë pasur përgjithësisht një ndikim të kahut rënës në inflacion. Nivelet e ulëta të inflacionit, gjatë dy viteve të fundit, kanë rritur fuqinë blerëse të familjeve shqiptare dhe kanë mbështetur zgjerimin e konsumit të tyre. Gjithashtu, ato kanë nxitur rritjen e investimeve të bizneseve, falë krijimit të një ambienti më të sigurt ekonomik dhe ruajtjes së normave afatgjata të interesit në nivele të ulëta.

Politika monetare e kujdesshme dhe konsistente e ndjekur nga Banka e Shqipërisë ka pasur një kontribut të padiskutueshëm pozitiv në këtë ecuri.

Fokusi i kësaj politike në ruajtjen e stabilitetit të çmimeve, si dhe harmonizimi i vazhdueshëm i saj me ecurinë e inflacionit, të politikës fiskale dhe të kursit të këmbimit, kanë mundësuar ruajtjen e stabilitetit të çmimeve me kosto minimale mbi aktivitetin ekonomik dhe treguesit e shëndetit të sektorit bankar.

Reduktimi i normës bazë të interesit në muajin korrik u shoqërua me një reduktim të normave të interesit në tregun e parasë, dhe në veçanti në atë të kredisë. Kjo lëvizje e politikës monetare ka lehtësuar kostot e huamarrjes së re dhe kostot e shërbimit të kredive ekzistuese. Për rrjedhojë, kredia për sektorin privat vijon të shënojë norma të shpejta dhe të qëndrueshme rritjeje, duke mbështetur zgjerimin e konsumit dhe të investimeve në vend.

Pritjet tona për të ardhmen kanë mbetur të pandryshuara. Përditësimi i parashikimeve tona sugjerojnë se ekonomia shqiptare do të vijojë të rritet me ritme të ngjashme rritjeje edhe në dy vitet në vijim, e nxitur nga kushte e favorshme të financimit, bilancet e shëndetshme financiare dhe klima pozitive e besimit në ekonomi. Nga ana tjetër, inflacioni pritet të kthehet në objektivin tonë prej 3% gjatë gjysmës së parë të vitit 2026, dhe të qëndrojë pranë këtij niveli edhe gjatë tremujorëve në vijim.



Në këto rrethana, pas shqyrtimit të këtij raporti tremujor, në mbledhjen e datës 5 nëntor 2025, ne gjykuam që qëndrimi aktual i politikës monetare mbetet i përshtatshëm për përmbushjen e objektivit tonë të stabilitetit të çmimeve dhe vendosëm të mbajmë të pandryshuar normën bazë të interesit, në nivelin 2.5%.

